



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 43 /2026
Datë: 24 . 03 .2026

Duke u mbështetur në nenet 9, 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 29 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Ligjit nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësorë, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeminstrija dhe Ministrija e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e z.Bujar (Arif) Lushaku, ekspert gjyqësor i prokurimit, për dorëheqje nga funksioni i ekspertit gjyqësor.
2. Emri i z. Bujar Lushaku shlyhet nga regjistri i ekspertëve gjyqësorë në pajtim me nenin 30 (paragrafi 1) të Ligjit nr.08/L-191 për Ekspertët Gjyqësorë.
3. Këtë vendim obligohet ta zbatojë Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Bujar Lushaku, me datë 18.02.2026, ka paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën me nr. protokoli 02-232 për dorëheqje nga funksioni i ekspertit gjyqësor në fushën e prokurimit, për shkaqe profesionale.

Dorëheqja është paraqitur për shkak të fillimit të procedurave për ushtrimin e veprimtarisë përmbaruese, e cila paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit të ekspertit gjyqësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës së tij dhe duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura, si dhe në legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë



Vendimi u dërgohet:

- Z. Bujar Lushaku;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.